

# Stop racizmit!

**Rinia e Unia-s kundër racizmit dhe ksenofobisë. Një dora**

Hartuar nga Sindikata Unia, dega e Migracionit dhe Rinisë, përkrahur nga Fondi i projekteve kundër racizmit dhe për të drejtat e njeriut, si dhe nga Shërbimi për çështje të rinisë pranë Enti Federal për Sigurime Sociale.



RACIZMI

**UNIA**

## Shkurtesat

- AVIG** Ligji mbi sigurimin në rast papunësie  
**BIZ** Qendra informuese e profesioneve  
**BV** Kushtetuta federale  
**EU** Bashkimi Evropian  
**GAV** KPP Kontrata e përgjithshme e punës  
**OR** E drejta detyrimore  
**SGB** BSZ, Bashkimi Sindikal i Zvicrës  
**StGB** Kodi penal

Ky doracak është botuar në gjuhët: Shqip, Gjermanisht, Frengjisht, Italisht, Spanjolle, Portugaleze, Serbokroatisht, dhe Turqisht.

**Adresa për porosi** Zentralsekretariat,  
IG Migration, Weltpoststrasse, 20,  
3000 Bern 15, migration@unia.ch,  
T 031 350 21 11

**Dizajni** Unia **Ilustrimi** Katharina Schwab  
**Shtypshkronja** s+z:gutzumdruck,  
Unia, Prill 2015

# Përmbajtja

Hyrje	4
Askush nuk është vërtetë racist, apo?	6
Racizmi: Çka është kjo saktësisht?	8
Racizmi i hapur dhe i fshehur	10
Diskriminimi gjatë shkollimit dhe kërkimit të praktikës shkollore	12
Racizmi në shkollën profesionale	16
Racizmi në vendin e punës	18
Racizmi nga ana e klientëve	20
Racizmi në rrethin e miqve	22
Diskriminimi në pagë	24
Unë jam dëshmitar	26
Ligjet kundër diskriminimit racial	28
Unë jam vetë viktimë: çfarë të bëj?	34
Adresat e rëndësishme	36
Ne mbrohemi!	42



Ti sigurisht je ballafaquar me racizmin dhe diskriminimin. Apo ndonjë kolegë/e pune, shok/qe, anëtar i familjes ka kërkuar ndihmën tënde, ose ke qenë ti vetë viktimë. Në këtë rast, sigurisht ia ke parashtruar vetes këto pyetje: Ishte ky vërtetë racizëm? Çfarë mund të bëj unë kundër racizmit? Si mund të ndikoj unë që kjo të mos ndodhë më? Kujt mund t'i drejtohem? Si mund të realizoj të drejtat e mia?

Për fat të keq, rastet e racizmit dhe diskriminimit janë duke u shtuar. Armiqësia kundër të huajve po bëhet e pranueshme në shoqëri. Në një shoqëri demokratike nuk duhet të ekzistojë racizmi dhe diskriminimi, sepse shkelin të drejtat themelore të njeriut dhe dinjitetin e personave të cenuar. Prandaj, të gjithë ata që duan të angazhohen për një shoqëri të drejtë dhe demokratike, duhet të angazhohen kundër racizmit, ta luftojnë edhe heqin qafe atë.

Ky doracak duhet të të ndihmojë për të vërejtur racizmin në vendin e punës, shoqëri dhe shkollë dhe për ta luftuar atë me efikasitet. Këtu gjen këshilla të dobishme dhe adresa, të cilat mund t'i konsultosh në rast nevojë.

Unia jote - sektori për rini



# Askush nuk është vërtetë racist, apo?

**«Unë nuk jam raciste,  
por këta Jugot e poshtër,  
më kupton...»**

Një grua

**«Kurrësesi nuk jam racist.  
Bile racistët i urrej. Mirëpo  
ne mund të kujdesemi që  
vendet e punës të rezervohen  
për zvicerane dhe zviceranë.»**

Një shegert

**«Të zinj të nuk i duroj dot. Ti je një përjashtim, sepse ti je shoku im!»**

Një kolegë shegert  
i thotë Zhan A.  
nga Kameruni



# Racizmi: çka është kjo saktësisht?

**Kush e vlerëson një njeri më pak të vlefshëm për shkak të ngjyrës, prejardhjes apo fesë së tij, vepron në mënyrë raciste. Për diskriminim racist nuk duhet të kesh bindje të theksuar raciste, çdokush mund ta bëjë këtë.**

**Diskriminimi është veprim:** Diskriminimi është vënia në pozitë të pabarabartë e një personi për shkak të prejardhjes kulturore apo sociale, gjinisë, orientimit seksual, moshës apo fesë.

**Racizmi është qëndrim:** Racizmi është një mënyrë e të menduarit, e cila vlerëson aftësitë dhe vetitë e një personi, duke marrë për bazë prejardhjen e tij.


**Ksenofobi** quhet «frika prej të huajve» dhe përket kryesisht si armiqësi kundër të huajve.



**Antisemitizmi:** Në mënyrë antisemite vepron ai i cili diskriminon një person me prejardhje hebreje, për shkak të fesë së tij.

**Nacionalizmi** përshkruan një ideologji politike, e cila mirëqenien dhe superioritetin kombit të vet e vë në qendër të vëmendjes. Nacionalizmi nuk mund të krahasohet me racizmin, por mund të shpie deri te ai.

Një listë me definicione në kontekst me racizmin mund ta gjesh nën [www.gggfon.ch](http://www.gggfon.ch)



# Racizmi i hapur dhe i fshehur

Diskriminimi racial mund të shprehet hapur apo fshehurazi.


**Diskriminimi i hapur racial** haset shumë rralë, sepse kryesit kanë frikë prej pasojave ligjore. Ky mund të zbulohet më lehtë dhe të ndiqet penalisht, siç tregojnë këta dy shembuj.

«**Ne nuk punësojmë shamia**», shkruan një punëdhënës i tërbuar në adresë të Qendrës regjionale për ndërmjetësim pune (RAV) në Cyrih. Unia e përfaqëson zviceranën e diskriminuar para gjykatës. Ajo e fiton procesin dhe merr një dëmshpërblim.

«**Për këtë vend shkollimi në profesion kemi paraparë një person të ri, të shka-thët dhe të ndërgjegjshëm. Vetëm zviceranë dhe shtetas të BE-së.**» Ka shpallje edhe më të këqija, kur hapur thuhet se kush nuk ka shanse: «**Nuk duam të rinj nga Ballkani**».

## **Racizmi i fshehur dhe diskriminimi**

mund të dëshmohe  
më vështirë, sepse per  
soni i cili diskriminon,  
mund ta fshehë vepr  
imin e tij mirë. Pikërisht  
tek racizmi i fshehur,  
njerëzit shpesh nuk  
janë të vetëdijshëm  
se sillen në mënyrë  
raciste. Mirëpo, edhe  
në rast të sjelljes së  
pavetëdijshme raciste,  
vlen: çfarë ndjenjash  
ngjall diskriminimi ra  
cist te viktima? Dhe  
çfarë pasojash mund  
të ketë?



# Diskriminimi gjatë shkollës së vendit për praktikë

Dardani, një i ri nga Kosova, lajmërohet në Qendrën për Informim mbi Profesionet dhe kërkon informata dhe një formular për t'u lajmëruar në gjimnaz.

Këshilltarja i thotë: «**Kjo është diçka vetëm për nxënës të mirë!**», pa i parë fare dëftesat e Dardanit. Dardani pyet veten: «**Do të më kishte ndodhur kjo, po të isha zviceran?**»

# limit dhe kërkimit

## Çfarë duhet bërë?

Dardani mund ta pyet këshilltaren: «Pse e thoni këtë? A mos mendoni se nuk jam nxënës i mirë, vetëm pse jam i huaj?» Sidoqoftë, Dardani duhet medoemos të ngulë këmbë në qëllimin e tij dhe të kërkojë informatat për gjimnaz. Përveç kësaj, ai mund ta përshkruajë atë që i ka ndodhur edhe në faqen e internetit [www.tschau.ch](http://www.tschau.ch). Vetëm kështu mund të bëhen publike rastet e tilla.



Sandra, zvicerane dhe Fatima nga Algjeria, konkurrojnë për të njëjtin vend për shkollim në profesion të tregtisë. Ato kanë qenë në të njëjtën klasë dhe i kanë ndihmuar njëra-tjetrës në kompletimin e dosjes për aplikim. Dosjet e tyre janë të ngjashme. Madje, Fatima i ka edhe notat pak më të mira se Sandra. Mirëpo, Sandra pranohet, kurse Fatima nuk ftohet madje as në intervistë.

## Çfarë duhet bërë?

Fatima duhet të kërkojë një bisedë me ndërmarrjen dhe të kërkojë të dijë se cilat janë shkaqet e refuzimit. Është vështirë të dëshmohet se Sandrës i është dhënë përparësi, vetëm pse është zvicerane. Për Fatimen është më së miri t'i drejtohet sektorit për çështje juridike në Unia, për të sqaruar mundësitë e marrjes së veprimeve ligjore kundër ndërmarrjes.



# Racizmi në shkollën profesionale

Hoze bën shkollimin profesional në një punëtori për përpunimin e metaleve. Punimi aktual duhej të notohej. Kolegu dhe fqinji i tij i tavolinës Beati, pa dashje merr punimin e Hozes dhe ia tregon mjeshtrit. Mjeshtri e vlerëson me notën 6. Beati e vëren gabimin dhe i tregon Hozesë. Kur Hoze shkon me të njëjtin punim te mjeshtri, ai e vlerëson me notën 4.5. Hoze ia përkujton mjeshtrit, se para pak çastesh të njëjtin punim e kishte vlerësuar me notën 6. Mjeshtri i thotë atij, se nuk dëshiron të diskutojë mbi vlerësimin e tij. Edhe pas dëshmisë së Beatit, mjeshtri mbetet kokëfortë.

## Çfarë duhet bërë?

Diskriminimi shpesh ka të bëjë me fuqinë dhe pafuqinë. Në këtë rast, mjeshtri është në pozitë të fuqishme dhe e (keq)përdor atë. Hoze, me ndihmën e Beatit, mund t'i drejtohet drejtorisë së shkollës dhe të përshkruajë ngjarjen- mundësisht



me fakte. Me rëndësi është edhe dokumentimi i rastit. Të vlefshme janë procesverbalet, shënimet personale ose edhe shkëmbimi i letrave në lidhje me rastin. Nëse mjeshtri nuk ndërron mendje dhe mbetet pranë vlerësimit të vet dhe shkolla nuk ndërmeret asgjë, atëherë Hoze mund të dërgojë rastin deri te instancat më të larta të arsimit. Edhe padia në gjykatë duhet të shqyrtohet. Nëse Hoze është anëtar i sindikatës, atëherë duhet t'i drejtohet sektorit për çështje juridike në Unia. Ose ai kontakton TikK-un në Zvicrën gjermane, gjegjësisht CCSI/SOS Racisme në Zvicrën franceze.



# Racizmi në vendin e punës

**«Në ndërmarrje vazhdimisht dëgjoj fjalë negative kundër vendasve të mi. Ndonjëherë tentoj të buzëqesh, ndonjëherë i them vetvetes se këta njerëz që bëjnë keq janë të marrë dhe se gjithkund ka njerëz të mirë dhe të këqij. Me kalimin e kohës më nuk mund t'i duroj këto fjalë. Kjo më streson dhe filloj t'i shikoj kolegët e mi si racistë. Nuk guxoj të them apo të ndërmarr diçka, nga frika se mund të izolohem apo të humb vendin e punës.»**

Miroslavi

## **Çfarë duhet bërë?**

Është me rëndësi që Miroslavi të mos lejojë që këto fjalë të kalojnë heshturazi, pa reaguuar. Ai duhet të diskutojë me ta për këtë dhe t'ua bëjë të qartë kolegëve se këto fjalë e lëndojnë. Nëse kjo nuk ka sukses, atëherë ai duhet t'i drejtohet

shefit apo komisionit të ndërmarrjes apo zyres për çështje të personelit.

Ai që vazhdimisht ballafaqohet me fjalë të tilla raciste, mund të sëmuret nga kjo. Nëse Miroslavi nuk gjen përkrahje në ndërmarrje, atëherë ai duhet t'i drejtohet sindikatës së vet. Ai gjithashtu mund të kontaktojë TikK në pjesën e Zvicrës gjermane ose CCSI/SOS Racisme në pjesën e Zvicrës franceze.



# Racizmi prej klientë/eve

Një mysafir i rregullt i thotë pronarit të restorantit aq zëshëm, për të dëgjuar kamerieri zeshkan Aimé: «**Shpresoj se mishi i pjekur nuk është aq i zi sikur ky kamerieri yt!**»

## Çfarë duhet bërë?

Klienti i rregullt e keqpërdor pozitën e tij superiore, sepse cili pronar i restorantit ka dëshirë të humb një myshteri të mirë. Mirëpo, kamerieri Aimé mund të kërkojë nga pronari, që ai ta mbrojë nga diskriminimi racist i klientëve. Aimé mund ta lutë pronarin, që ai t'ia tërheq vërejtjen klientëve dhe t'ua bëjë me dije se këto shprehje e lëndojnë punëtorin e tij. Ndodhë që punonjësit

të rrezikojnë humbjen e vendit të punës, apo transferimin në një vend tjetër, ku nuk kanë më kontakte me klientët. Nëse ndodhë një gjë e tillë, atëherë Aimé mund të ndërmarrë hapa ligjorë, me ndihmën e sindikatës. Ai mund të kontaktoi edhe TikK në Zvicrën gjermane, gjegjësisht CCSI/SOS Racisme në Zvicrën frënge.



# Racizmi në mesin e miqëve

Markusi tregon një barcoletë (shaka) për të huajt: «**Në një automobil janë një turk, një jugo dhe një zezak. Kush e nget automobilin? Polici!**» Mirëpo, ai i drejtohet shokut të tij Hakimit: «**E di se ndoshta kjo të lëndon, por m'u desh patjetër ta tregoj këtë barcoletë, sepse është aq qesharake!**»

## Çfarë duhet bërë?

Është shumë me rëndësi që sinqerisht dhe hap-tazi të thuhet, se një gjë e tillë lëndon. Thënie agresive si «Ti je racist!», ose reagimi i dhunshëm apo kërcënimi, sigurisht se nuk kontribuojnë në përmirësimin e situatës. Nga ana tjetër, nëse

ti menjëherë i shpreh  
ndjenjat e tua, atëherë në  
mesin e shokëve mund të  
bisedohet me argumente  
dhe pa emocione. Porosite  
broshurën komike «Ich  
Rassist?!» tek Fondacioni  
Bildung und Entwicklung  
(5.- frang, porosia mund  
të bëhet edhe në: [laden@  
globaleducation.ch](mailto:laden@globaleducation.ch)).



# Diskriminimi në pagë

Në Zvicër askush nuk flet për rrogën e tij. Manueli ka përshtypjen se paguhet më pak sesa kolegët e tij, sepse është i huaj, edhe pse ka të njëjtat kualifikime. Mirëpo, nuk di se si ta zbulojë këtë.

## Çfarë duhet bërë?

Nëse dega ku ai punon është në jurisdikcionin e KPP-së, atëherë ai mund të pyes në Unia, se cilat paga janë të parapara me KPP. Përndryshe, ndihmon edhe llogaritësi i pagës i BSZ-së [www.lohnrechner.ch](http://www.lohnrechner.ch). Aty ai mund të llogarisë pagën e zakonshme në regjionin dhe degën ku



ai punon, bazuar në shkallën e arsimimit, kualifikimin, vendin e punës profesionin e tij. Nëse paga e tij nuk përputhet me këtë pagë të zakonshme, që nxjerr makina llogaritëse, atëherë ai duhet të bisedojë me shefin e tij. Si anëtar i sindikatës, në lidhje me këtë, në fillim ti mund të diskutosh me seksionin tënd të Unia.



# Unë jam dëshmitar

## **Unë jam dëshmitar i një diskriminimi racial, por nuk jam i përzier drejtpërsëdrejti. A mund të bëj diçka?**

Është me rëndësi që ne të mos jemi indiferent, sepse racizmi dhe diskriminimi janë të rrezikshëm për shoqërinë tonë! Edhe si dëshmitar, ti duhet të kundërshtosh dhe të inkurajosh viktimën, që ai/ajo të veprojë. Nëse ti e përkrah viktimën, atëherë viktima ka më shumë guxim të mbrohet. Me rëndësi është po ashtu që, rastet e racizmit të bëhen publike. Këtu mund të marrësh ndihmë nga Rinia e Unia-s dhe grupet që luftojnë kundër racizmit. Presioni publik shpeshherë është mjeti më i mirë kundër diskriminimit racial. Kjo quhet Kurajo qytetare! gggfon ofron këshilla konkrete të veprimit në lidhje me Kurajon qytetare.



# Ligjet kundër diskriminimit racial

## **Hopa, tash të zumë, racist! Për ty tash do të kujdeset ligji!**

Na vjen keq, mirëpo ligjet zvicerane shumë dobët e luftojnë racizmin dhe diskriminimin. Ne, sindikatat, jemi duke punuar në përmirësimin e tyre, në mënyrë që racizmi dhe diskriminimi të mos mbeten edhe mëtej «mëkat i lehtë». P.sh. ne kërkojmë futjen e një neni kundër diskriminimit në KPP, bashkëpunojmë me grupet kundër racizmit, angazhohemi për ashpërsimin e ndëshkimit penal kundër racizmit, organizojmë aksione dhe bëjmë publike rastet e diskriminimit racial.

Megjithatë, ligji të ofron edhe disa mundësi për t'u mbrojtur:



---

## **Çfarë thotë ligji?**

---

Para ligjit të gjithë jemi të barabartë, askush nuk guxon të diskriminohet. (BV 8)

---

Çdokush që publikisht shprehet në mënyrë raciste, apo diskriminon njerëzit në baza raciale, do të dënohet (StGB 261 bis).

---

Ndërmarrja jote është e detyruar të të mbrojë nga racizmi (i klientëve apo i kolegëve) (OR 328).

---

---

## Kujdes!

---

Kjo normë kushtetuese, fatkeqësisht nuk është zbatuar plotësisht në legjislacion: P.sh. nuk kemi ligj kundër diskriminimit.

---

Është shumë vështirë mardje që edhe racistët më të tmerrshëm të ndëshkohen. Shprehjet raciste në ambiente private nuk janë të dënueshme.

---

Nuk lehtë që një punëdhënës ta detyrosh të bëjë diçka. Nise procedurën ligjore vetëm nëse je i sigurtë se nuk «rrezikon» veten.

---



---

## Çfarë thotë ligji?

---

Nëse largohesh nga puna për arsye raciste, atëherë largimi është abuzues. (OR 336 Abs. 1a).

---

Nëse ti je viktimë e racizmit në vendin e punës, atëherë kjo punë nuk mund të kërkohet edhe më tutje nga ti (AVIG 16 Abs. 2). Nëse ti për këtë arsye vendos të largohesh nga puna, atëherë Arka e papunësisë (ALV) nuk mund të shkurtojë ditët e pagesës.

---



---

## Kujdes!

---

Zakonisht, largimi nga puna nuk mund të anulohet, mirëpo ti ke të drejtën e dëmshpërblimit prej 3–6 pagave mujore. Kujdes: të duhen prova!

---

Ti duhet të kërkosh nga punëdhënësi yt, që ai të parandalojë racizmin. Vetëm nëse ai bën pak apo asgjë kundër, ti ke të drejtë të anulosh kontratën e punës, pa rrezikuar shkurtimin e ditëve të paguara nga Arka e Papunësisë.

---



# Unë vetë jam viktimë: si të veprojmë?

Bisedo për këtë me kolege/ët dhe shokët/qet e tua, zhvilloni së bashku ide dhe strategji, tematizoni në klasën tuaj dhe në rrethin tuaj të miqëve. Po ashtu ekzistojnë edhe grupe të ndryshme kundër racizmit (p.sh. Rinia e Unia, shih po ashtu listën në faqe 36 të këtij doracaku), të cilat mund t'ju ndihmojnë që t'i kundërviheni në mënyrë aktive racizmit, apo të bëni publike rastet e racizmit.



# Adresat e rëndësishme

**Sindikata Unia:** [www.unia/jugend](http://www.unia/jugend)

**Këshillimoret e specializuara kundër racizmit.**

---

**CCSI/SOS Racisme** (në Zvicrën franceze) Rue des Alpes 11, CP 366, 1701 Fribourg, 026 424 21 25, [ccsi-fr.ch](http://ccsi-fr.ch)

**Beratungsnetz für Rassismusopfer**

Rrjeti prej 11 Këshillimoreve nga e tërë Zvicra, [network-racism.ch](http://network-racism.ch), [beratungsnetz@humanrights.ch](mailto:beratungsnetz@humanrights.ch)

**Së bashku kundër racizmit dhe dhunës**

031 333 33 40, [gggfon.ch](http://gggfon.ch)

**Integres** (Region Schaffhausen) 052 630 06 40/43, [isah.schaffhausen@sah-sh.ch](mailto:isah.schaffhausen@sah-sh.ch)

**SOS Rassismus, Multimondo**

(Regjioni Biel, Seeland, kufiri me Zvicrën Perëndimore), 032 322 50 20, [sos.rassismus@multimondo.ch](mailto:sos.rassismus@multimondo.ch)

## **CaBi – Antirassismus Treff**

Linsebühlstrasse 47, 9000  
St. Gallen, [cabi-sg.ch](http://cabi-sg.ch)

**Stopp Rassismus** (Region  
Nordwestschweiz) edhe këshillime  
online, 061 821 44 55

[stopprassismus.ch](http://stopprassismus.ch)

**Tikk** Taskforce interkulturelle  
Konflikte (Taskforca për  
konflikte ndër-kulturore),  
044 291 65 75, [tikk.ch](http://tikk.ch)

## **Lista e të gjitha**

**Këshillimoreve** E radhitur  
sipas Kantoneve dhe gjuhëve,

[www.edi.admin.ch/frb/  
adressen/](http://www.edi.admin.ch/frb/adressen/)



**Projekte kundër racizmit prej shkollave dhe për shkolla** 031 389 20 24,  
[www.education21.ch](http://www.education21.ch)

**Për refugjatë**

---

**SFH-OSAR, Flüchtlingshilfe Schweiz**

Bern: 031 370 75 75, Lausanne:  
021 320 56 41, Lugano: 091 923 17 76,  
[fluechtlingshilfe.ch](http://fluechtlingshilfe.ch)

**Fondacioni Edukimi dhe Toleranca në Cyrih**

044 349 89 66, [set-toleranz.ch](http://set-toleranz.ch)

**Fondacioni Edukimi dhe Zhvillimi në**

**Bernë** 031 389 20 21, [globaleducation.ch](http://globaleducation.ch)

**Shoqata dhe grupime kundër racizmit**

---

**Fondacioni kundër racizmit dhe anitsemi-**

**tizmit** 044 218 50 30, [gra.ch](http://gra.ch)

**Solidariteti pa kufi** 031 311 07 70,

sekretariat@sosf.ch, [sosf.ch](http://sosf.ch)

**Klartext – Kultura rinore kundër racizmit** (Projekte për të rinj) 033 221 73 00, [welcome@klartext-online.ch](mailto:welcome@klartext-online.ch)

**Augenauf**

Basel: 061 681 55 22,  
Bern: 031 332 02 35,  
Zürich: 044 241 11 77,  
[augenauf.ch](http://augenauf.ch)

**Antifa** [info@antifa.ch](mailto:info@antifa.ch),  
[antifa.ch](http://antifa.ch), [info@buendnis-gegen-rechts.ch](mailto:info@buendnis-gegen-rechts.ch), [buendnis-gegen-rechts.ch](http://buendnis-gegen-rechts.ch)

**Këshillimore juridike për specialistë dhe rretëzim i këshillimoreve**  
031 302 01 61,  
[humanrights.ch/MERS](http://humanrights.ch/MERS)



# Ne mbrohemi!

Politika armiqësore e qarqeve të djathta kundër të huajve dhe azilkërkuesve, nxitë armiqësinë ndaj të huajve dhe racizmin. Në opinion krijohet bindja e përgjithshme se, të huajt janë vetëm kriminelë potencialë dhe refugjatë të rrejshëm. Me këtë ushqehet trolli i përshtatshëm për racistët, nacionalistët dhe fashistët. Racizmi i pandërgjegjshëm i kafeneve tradicionale, bëhet shoqërisht i pranueshëm.



Kësaj ne duhet t'i kundërvihemi të gjithë! Sepse racizmi nuk përputhet me shoqërinë tonë demokratike, të hapur dhe tolerante. Ai/ajo i/e cili/a e vëren racizmin, e bën publik, e lufton dhe mënjanon, jep një kontribut të rëndësishëm për ruajtjen dhe zhvillimin e demokracisë sonë.



# Rinia e Unia

**Unia është organizata më e madhe e punëmarrësve në Zvicër. Në të janë organizuar mbi 80 degë. Grupi i interesit (GI) të të rinjëve përfaqëson interesat e nxënësve dhe punëmarrësve të rinjë.**

Qoftë kundër shkurtimeve të mirëqenies dhe racizmit apo për pagat minimale, barazinë dhe drejtësinë shoqërore: te Rinia e Unia-s ti mund të angazhohesh së bashku me të tjerët, për kushte më të mira të punës dhe ngritje të mëtutjeshme, si dhe për një botë më të mirë.

Së bashku ne arrijmë më shumë. Jo të gjithë nxënësit do të kenë pesë apo gjashtë javë pushime, po të detyroheshin të bënin marrëveshje individuale me shefat e tyre. Punëmarrësit së bashku janë të fortë dhe nuk mund të nxiten kundër njëri-tjetrit.

Prandaj punëmarrësit dhe punëmarrëset janë bashkuar me sindikatat. Së bashku ata angazhohen për kushte më të mira të punës.

Bashkëvepro edhe ti në Rininë e Unia-s dhe ndihmo që Zvicra të bëhet pak më e drejtë.

**Vetëm së bashku ne jemi të fortë!**





**Jugend.**

**Unia Zentralsekretariat**

IG Jugend

Weltpoststrasse 20

Postfach 272

3000 Bern 15

T +41 31 350 23 36

jugend@unia.ch

**[www.unia.ch/jugend](http://www.unia.ch/jugend)**